BIBLIOTEKA
SHTETIT
81H-7
M 57

# PETRIT MEKSI



# Buzagaz

poezi humoristike

8JH-7
N1 57.

PETRIT MEKSI

# *BUZAGAZ*

***poezi humoristike***

BIBLIOTEKA E SHTETIT
INV. 13511

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 2000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja Re
Tiranë, 1977

## DIL, MOJ KËNGË!

Strofa thuret me mundim,
vjersha rritet dalngadalë;
nga një varg u bë vëllim —
ësht' një pjesë nga shpirti im
që i qeshur do të dalë.

Dil, pra, dil se kam dëshirë,
rrahi flatrat gjithë gaz;
pranë njerëzve zemërmirë
ulu, ulu, je e lirë,
s'je si zogu në kafaz.

Pranë tyre këndo shtruar
dhe po qeshën mos nxito, —
janë njerëz të gëzuar;
kush ul kokën i thumbuar
hapi zemrën, kuvendo.

Për armiqt', kudo të jenë,
mprihu, këngë, si një thikë.
Fluturo, pra, le folenë,
këng' e zemrës, dil merr dhenë,
si bilbil ktheja me grykë.



## Ç'JANË KËTA?!

Prilli sapo kishte hyrë[1])
për burokratët mynxyrë:
— Ç'jan' këta që vijn' në zyrë?
Un' as kafen s'e kam pirë!

Pa nis bie telefoni:
— Alo! Alo! Si urdhëroni!
Eni vetë ta shikoni! —
tundet dera dhe ballkoni.

S'janë shefa e drejtorë,
janë gjithë punëtorë,
farkëtarë, muratorë...
Vallë pse në këtë orë?

---

1) Më 3 prill 1975 në gazetën «Zëri i popullit» u botua kryeartikulli «Kur flet klasa, nuk flet burokratizmi».



(Alo! Foł e jep shpjegim,
do të jetë keqkuptim...)

– Ç'të të them, o ditënxirë!
Është klasa që ka hyrë.
Ajo vjen si tallaz deti
se i saja është pushteti.

## KËRKESË

E madhe ësht' e vërteta,
e madhe.
Për nder!
Njëzet e një vjet djersë
po derdh në dikaster.
E mbaj mend fort mirë:
erdha çunak,
u bëra burrë —
thash' do dal plak,
po s'qenkërka e thënë...
Atëherë ju lutem
ta mbani shënim:
«Filani vetë kërkon qarkullim».
U mykëm, shokë,
u mykëm vërtet...
Ku do qarkulloj?
E kam gjetur vetë:
në ndërmarrjen vartëse,
këtu, në kryeqytet...

